



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e X-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 shtator 2022 në  
sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 10:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Lorik Maxhuni.

Gjithashu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i komunës), Drejtoret e drejtive, Ismet Gashi nga zyra ligjore, Faton Hyseni, kryesues i komisionit të kuvendit për verifikimin e procesit të dhënies së pronës në shfrytëzim në Stanoc të Epërm dhe Pestovë, Galip Avdiu, kryesues i grupit vlerësues për identifikimin e shtëpi – shkollave, Bekim Zabërgja, kryesues i komisionit të kuvendit për verifikimin e procesit të dhënies së pronës në shfrytëzim, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – theksoi se si komision i kuvendit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, kemi mbajtur një takim dhe e kemi hartuar një orar për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Prandaj, ai propozoi që ky orar të shkojë në kuvend dhe të njoftohen të gjithë anëtarët e kuvendit

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:*

### R E N D D I T E

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.7.2022;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 27.7.2022;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 31.8.2022;
- Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2023;
- Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2022;
- Shqyrtimi i propozim –vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave;
- Shqyrtimi i Informatës përfundimin e korrije-shirjeve dhe përgatitjet përmblidjet vjeshtore;

8. Rishikimi i Planit të Veprimit për të gjeturat e Auditorit;
  9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;
  10. Rishqyrtimi i vendimit nr. 81/21 i datës 16.4.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumad;
  11. Shqyrtimi i Raportit i komisionit të kuvendit të komunës lidhur me verifikimin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim në fshatin Stanoc i Epërm;
  12. Shqyrtimi i Raportit i komisionit të kuvendit të komunës lidhur me konstatimin e gjendjes faktike të objektit në fshatin Pestovë, si dhe shqyrtimi i kundër peticionit lidhur me këtë çështje;
  13. Shqyrtimi i Raportit të punës nga grupi vlerësues për identifikimin e shtëpive – shkolla;
  14. Të ndryshme.
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.7.2022.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15.7.2022.*

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 27.7.2022.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme të datës 27.7.2022.*

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 31.8.2022.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme të datës 31.8.2022.*

4. Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2023.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha qysh e kemi biseduar edhe në KPF e kuvend, ende nuk na ka ardhë lista e rrugëve për asfaltim e kubëza, gjë që kryetari është zotuar se do të jetë transparent lidhur me këtë çështje. Nuk e di pse po mbahet fshehtë kjo çështje, sepse kjo punë do të dihet se do të publikohet tenderi në ëebfaqe.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – deklaroit se nuk po fshehet asgjë, por lista e rrugëve do të vjen, sepse është duke u përgatitur. Ai tha se ka qenë një kontratë – kornizë për hartimin e projekteve dhe deri në momentet e fundit nuk kemi pasur mundësi ta shkëpusim atë kontratë. Tani, inxhinierët janë dukë i bërë paramasat dhe parallogaritë për secilën rrugë. Prandaj, në seancën e kuvendit do ta keni listën dhe do ta keni mundësinë për të diskutuar.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – theksoi se edhe ne si LDK jemi për ta proceduar në kuvend, me shpresë që do të vjen lista e rrugëve.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, rekandroi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershori 2022.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për”, rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i propozim –vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se në kuadër të Ligjit për Tatimin në Pronë dhe Rregullores, duhet caktuar edhe normat tatimore. Fillimisht duhet t'i caktojmë zonat, pastaj normat tatimore.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – pyeti se a ka të bëjë Harta Zonale me zonat tatimore?

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – theksoi se Harta Zonale nuk ka të bëjë me zonat tatimore. Por, shërben si ndihmesë për punëtorët në terren përcaktimin e zonave tatimore.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e korrije-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.

**Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** – tha se sipas planit të punës së kuvendit, e kemi përgatitur këtë informatë. Tani jemi duke u marrë me përgatitjet për mbjelljet vjeshore.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – kërkoi që për kuvend të na bashkëngjiten të dhënët nga viti paraprak, në mënyrë që të bëjmë krahasime se si është gjendja.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

8. Rishikimi i Planit të Veprimit për të gjeturat e Auditorit.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – theksoi se ky material ka të bëjë me vitin e kaluar. Por, rekomandimet që i ka dhënë auditori, si qeveri jemi të obliguar që t'i implementojmë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – kërkoi që për kuvend, kësaj informate t'i bashkëngjitet edhe lista e pronave që janë në shfrytëzim dhe emrat e shfrytëzuesve.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

10. Rishqyrtimi i vendimit nr. 81/21 i datës 16.4.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

**Bekim Zabërgja, kryesues i komisionit të kuvendit për verifikimin e procesit të dhënies së pronës në shfrytëzim** – tha se në bazë të kuvendit që kemi marrë si komision, e kemi dorëzuar raportin. Prandaj, kushdo që ka ndonjë pyetje dhe ndonjë paqartësi jam i gatshëm me iu përgjigj.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – e kam lexuar raportin përfundimtar që e ka dërguar komisioni, besoj që do të kemi kohë më shumë për kuvend ta analizojmë si grup. Ai pyeti se institucionet tjera a kanë sjellë ndonjë verdikt lidhur me këtë çështje, apo mos ka mbetur situata pezull? Sepse, ne kemi informacione se disa institucione janë marrë me këtë çështje. Prandaj, mos po bëjmë ndonjë ndërhyrje në proces.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – theksoi se e tëra që kemi është shkresa e Agjencionit Kundër Korruptionit lidhur me konfliktin e interesit gjatë procesit të votimit. Po ashtu, e kemi edhe opinionin e zyrës ligjore, ku thuhet se e drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë. Lënda në fjalë është në proces të hetimeve nga institucionet. Ai tha se lëndën e ka marrë vonë nga Ministria e Tregtisë se është në menaxhim të komunës, pra pasi që e kam marrë mandatin. Kur janë marrë këto vendime, nuk ka pasur pranim teknik dhe nuk i ka kaluar komunës në menaxhim.

Është në mandatin e juaj si deputetë që ta diskutoni, t'i rishikoni dhe t'i analizoni me hollësi dhe mos të bëjmë shkelje më shumë deri në këtë proces

Nuk jam i interesuar as që t'i dëmtojmë bizneset, por as nuk i interesuar që juve të ju vë në lajthitje me shkel ligjin që nesër të merret dikush edhe me neve.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – pasi që lënda është në hetuesi (prokurori apo gjykatë) e tëra që ne mund të bëjmë në kuvend është që vetëm të diskutojmë, sepse nuk kemi të drejtë të marrim ndonjë vendim. Prandaj, konsideroj që duhet të presim derisa organet e drejtësisë ta jepin verdiktin e tyre.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – tha se ne si grup parlamentar, por edhe unë si anëtar i komisionit konsiderojmë se përderisa nuk kemi ndonjë vendim nga instancat tjera, jemi të obliguar që ta procedojmë në kuvend këtë çështje që e ka kërkuar Agjencionit Kundër Korruptionit. Si komisioni, besoj që e kemi kryer punën më të mirë të mundshme lidhur me këtë çështje. Prandaj, ai propozoi që të procedohet në kuvend.

**Bekim Zabërgja, kryesues i komisionit të kuvendit për verifikimin e procesit të dhënies së pronës në shfrytëzim** – sa i përket shqetësimeve që u ngritën se lënda është në organë të hetuesisë. Ai tha se kjo është çështje e tyre që ta kryejnë punën e tyre. Kurse, ne si përfaqësues të zgjedhur të popullit e kemi obligim që t'i kryejmë detyrat tona. Prandaj, kjo çështje duhet të procedohet në kuvend dhe kuvendi duhet të vendos. Sepse, kemi një rekomandim nga Agjencionit Kundër Korruptionit që ta rishqyrojmirë këtë vendim. Ai propozoi që organet e hetuesisë të marrin pjesë në kuvend dhe të dëgjojnë diskutimet e anëtarëve të kuvendit.

**Ismet Gashi, nga zyra ligjore** – deklaroit se ka qenë obligim ligjor (pa kaluar fare në KPF) që kuvendi ta shqyrtojë, përfaktin se Agjencionit Kundër Korruptionit i ka rekomanduar kryesueses

së kuvendit që ta rishqyrtojë edhe një herë kuvendi vetëm çështjen e votimit. Kurse, çështjet që kanë lindur në ndërkoħe janë çështje tħera. Ndërsa, çështjet që i ka ngritur komisioni në raport, ato dojnë analizë tē thuktē tē organeve përgjegjèse.

Prandaj, kjo pikë èshtë obligim që tē procedohet në kuvend dhe tē vendoset në rishqyrtim çështja e votimit.

*Lidhur me kêtë pikë tē rendit tē ditës, KPF-ja njëzéri rekomoñdoi që tē procedohet pér shqyrtim në Kuvend, nē mbledhjen e radhës.*

11. Shqyrtimi i Raportit i komisionit tē kuvendit tē komunës lidhur me verifikimin e dhënies së pronës komunale nē shfrytëzim nē fshatin Stanoc i Epërm.

**Faton Hyseni, kryesues i komisionit tē kuvendit pér verifikimin e procesit tē dhënies së pronës nē shfrytëzim nē Stanoc tē Epërm** – deklaroi se si komision kanë dalë nē terren dhe e kanë hartuar kêtë raport sipas gjendjes faktike.

*Lidhur me kêtë pikë tē rendit tē ditës, KPF-ja njëzéri rekomoñdoi që tē procedohet pér shqyrtim në Kuvend, nē mbledhjen e radhës.*

12. Shqyrtimi i Raportit i komisionit tē kuvendit tē komunës lidhur me konstatimin e gjendjes faktike tē objektit nē fshatin Pestovë, si dhe shqyrtimi i kundër peticionit lidhur me kêtë çështje.

**Agron Pérçuku, anëtar i KPF-së** – kérkoi që bashkë me kêtë material, t'i bashkëngjiten edhe dokumentacionet nga Drejtoria pér Inspektore lidhur me inspektimet që janë bérë nē kêtë objekt.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – pér dallim nga rasti nē Stanoc tē Epërm ku janë dhënë rekomandime, pér rastin nē Pestovë nuk janë dhënë rekomandime, por vetëm disa informata. Ai pyeti se pse nuk ka rekomandime pér kêtë rast?

**Faton Hyseni, kryesues i komisionit tē kuvendit lidhur me konstatimin e gjendjes faktike tē objektit nē fshatin Pestovë** – tha se edhe pse nuk janë dhënë rekomandime, shumë mirë sqarohet nē raport: “Ne konsiderojmë se nē atē objekt nuk mund tē marrim masa shtesë deri sa objekti èshtë nē punime e sipér dhe pér ćka pala èshtë e obliguar tē prezantojë raport pér secilën fazë tē ndërtimit sipas lejes ndërtimore deri nē fazën e pranimit teknik e pastaj funksionalizimit tē tij sipas normave ligjore”.

“Vlen tē ceket se ne jemi njoftuar se ka një peticion tē dytë nga ana e banorëve tē këtyre fshatrave ku shpreh tē kundërtēn e peticionit tē parë tē cilin jemi duke e trajtuar, peticioni èshtë me një numér tē konsiderueshém tē banorëve që e shprehin tē kundërtēn e peticionit nē fjalë, përkatesisht pérkrahjen e këtij biznesi i cili po synohet tē funksionalizohet”, u shpreh Hyseni.

*Pas debatit lidhur me kêtë pikë tē rendit tē ditës, KPF-ja njëzéri rekomoñdoi që tē procedohet pér shqyrtim në Kuvend, nē mbledhjen e radhës.*

13. Shqyrtimi i Raportit tē punës nga grupei vlerësues pér identifikimin e shtëpive – shkolla.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – nē kêtë informatë e pashë që èshtë përfshirë niveli i mesém. Ai pyeti, se niveli fillor dhe i ultë, a ka funksionuar normalisht apo nuk èshtë përfshirë?

**Galip Avdiu, kryesues i grupit vlerësues për identifikimin e shtëpi – shkollave – deklaroi se në vitet e 90-ta janë përjashtuar nga objektet shkollore mësuesit dhe nxënësit të nivelit të mesëm. Kurse, të nivelit fillor kanë punuar në objektet filllore. Pra, largimi i mësimdhënësve dhe nxënësve dhe fillimi i punës nëpër shtëpi – shkolla ka ndodhur nga viti 1990 deri më 1994. Pastaj, mësimdhënësit dhe nxënësit e nivelit të mesëm kanë filluar punën kryesisht nëpër objektet e shkollave filllore.**

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

14. Të ndryshme.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – në këtë informatë

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

Bujar Klinaku

  
Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

  
Kryesuese e KK-së dhe e KPF- së